



TRE NDJESI TË NJË DITE
TË ZAKONSHME RAMAZANI
NË SHKODËR...



LUTJA E HATMES
SË KUR'ANIT TEJMBUSH
XHAMINË E PARRUCËS



U GËZOFSHIN TË GJITHË
MUSLIMANËT, KUDO QË JANË
ANË E KËND BOTËS

Viti XIV - Nr. 6 (160),
Qershor, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

FITËR BAJRAMI, TRADITË BESIMI POPULLORE NË SHKODËR

"All-llahu ju dashtë dhe ju begatoftë jetën tuaj!

Ju mbrojtë nga çdo e keqe dhe paudhësi!

E begatoftë Shkodrën tonë

dhe e forcoftë Islamin në zemrat e muslimanëve të saj!

E begtoftë Shqipërinë tonë të shtrenjtë dhe na bëftë të respektueshëm
ndaj hakut të saj në ndërgjegjen e gjithësecilit prej nesh!"



MESAZH ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1437/2016

Shfaqeni kudo gëzimin e Fitër Bajramit, ndajeni mirësinë në mes vete, dëbojeni shejtanin nga jeta dhe forcojeni lidhjen me All-llahun Fuqiptotë

Të dashur dhe të nderuar vëllezër dhe motra besimtarë,

Është mirësi e madhe nga Mëshirëploti All-llah, i Cili na dha mbarësi ta agjërojmë Ramazanin e këtij viti në mënyrë masive, duke dëshmuar plot dinjitet e krenari rrugëtimet tona drejt përsosmërisë shpirtërore dhe shfaqjes, përherë e më shumë si muslimanë, të lidhur fort pas mësimave dhe udhëzimeve të Kur'anit Famëlartë dhe traditave të Hz. Muhammedit (a.s).

Gjatë këtij Muaji dëshmuam bashkarisht një rritje cilësore drejt adhurimeve të sinqerta, që burojnë nga paqja e shpirtit, mëshira e zemrës dhe urtësia e mendjes, të lidhura e të nënshtruara para vullnetit të All-llahut Mëshirëbërës, për të përfituar secili prej nesh mëshirën, faljen dhe bekimet e Tij në jetën tonë kalimtare dhe në të përtejmen e përjetshme.

Tashmë, dita e martë, më 5 korrik 2016, është e para e ditëve të Fitër Bajramit, festës së madhe, në të cilën gëzojmë së bashku, duke dhuruar mëshirë e dashuri për krejt

krijesat e Zotit, veçanërisht në mesin e muslimanëve, të thirrur për ta ndërtuar jetën me Dritën e udhëzimit hyjnor.

Bajrami i vërtetë është atëherë, kur vendi ynë jeton në mirëqenie, në siguri, në paqe e harmoni, në moral e dije, në kulturë të shëndoshë e politika ndërtuese për shoqërinë dhe kombin, në vlera tabani dhe krenari identitare, që na bëjnë të ndjehemi krenar me vendin tonë, me tokën tonë, me emrin Shqipëri, kudo që jemi e me këdo që të jemi!

Bajrami i vërtetë është paqtimi i zemrave dhe pastrimi i realiteteve tona shqiptare nga hilet, nga pabesitë, nga shthurja morale, intelektuale dhe politike, nga prapambetja shkencore dhe varfëria ekstreme, nga skamja dhe padrejtësitë, nga tentativat e ulëta për të abuzuar me fenë, mesazhet hyjnore dhe identitetin real të besimit tek shqiptarët!

Të dashur vëllezër të shtrenjtë muslimanë,

Jetoheni Islamit tuaj me krenari, dëshmojeni kudo shpirtin e tij, me bindje e forcë karakteri, me

ndërgjegje të pastër, me mëshirë për krejt krijesat e Zotit, i Cili e dërgoi të fundin e profetëve të Tij, "mëshirë për mbarë botët"!

Ju, të shtrenjtë vëllezër muslimanë, jeni mëshirë e dhuruar, jeni paqtim garant në shoqëri, jeni mbrojtës të vlerave të tolerancës dhe dëbues me përbuzje të cinizmit mesjetar, që vret, djeg e dhunon me maskën e pabesisë mbi fytyrën katran!

Shfaqeni kudo gëzimin e Fitër Bajramit, ndajeni mirësinë në mes vete, dëbojeni shejtanin nga jeta dhe forcojeni lidhjen me All-llahun Fuqiptotë, që na nxori nga errësira në dritë, nga injoranca në dije, nga humbja në triumf, duke e bekuar jetën tonë me këtë Islam të mrekullueshëm!

All-llahu e begatofte Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë trojet shqiptare!

Gëzuar Fitër Bajramin mbarë ymmetit islam!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 4 korrik 2016

عید پاک



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

TRE NDJESI TË NJË DITE TË ZAKONSHME RAMAZANI NË SHKODËR...

(Ndoshta, do të duhet të organizojmë edhe faljen e ndonjë teravie në xhaminë e dhunuar të kalasë Rozafa, për të gjetur shenjat e kësaj qetësie dhe kënaqësie shpirtërore, që dhurohet falas në ambientet e xhamisë së Plumbit)

Ditën e sotme përjetova tre momente interesante, që më dhuruan ndjesi të ndryshme nga njëra-tjetra, por që gjithsesi, mbeten pjesë e kësaj dite, dielli i së cilës tashmë ka perënduar me kohë...

1) Sot vizitova gjyshin dhe nanen. Në heshtjen e varreve të tyre dhe viteve të gjata të mosprezencës fizike, këndimi i Fatihës dhe ca lutjeve për shpirtin e tyre, e zbutën atmosferën, duke e gjallëruar përmes kujtimeve të largëta... Qëndronin mbi kokën time, ndonëse nuk e ndalnin dinamikën e lëvizjes...

Teksa lexoja datat e largimit të tyre nga bota jonë kalimtare, 1987 dhe 2000, më bëhej se koha e gjatë e mungesës i kishte kthyer në gjurmë të lashtë historie, ndonëse shenja e tyre në shpirtin tim më thoshte se modelet nuk i prek lashtësia, modelet mbeten shembuj për t'u respektuar e gjurmë për t'u ndjekur në jetë...

Nana, një grua e heshtur, pastërtore, mikpritëse, bujare, edukatore (në kuptimin e vërtetë të fjalës), muslimane zamani..!

Gjyshi, një burrë durimtar, thellësisht besimtar e musliman praktikant, burrnor e i urtë, njeri i fjalës, zemërbardhë e sakrifikues i madh..!

2) Teravinë e kësaj nate e falëm në xhaminë e Dudasit. (E falëm, meqë nuk isha vetëm). M'u mbush zemra me kënaqësi e prekje traditash, që ruajnë me fanatizëm fenë e të parëve, gjurmën e tyre dhe shpirtin e shekujve, që të lidhin me burimin e Dritës dhe Udhëzimit, Hz. Muhammedin (a.s) dhe sahabët e tij.

Qetësi, pastërti, dritë, prehje,

salavate, ngrohtësi tek besimtarët..., të gjitha ishin mbledhur aty në këtë natë. Namazin e teravisë me 20 rekatet e veta, i falëm bashkërisht, me një përshpirtje, që i ngjan asaj që të dhuron xhamia e Plumbit. (Ndoshta, do të duhet të organizojmë edhe faljen e ndonjë teravie në xhaminë e dhunuar të kalasë Rozafa, për të gjetur shenjat e kësaj qetësie dhe kënaqësie shpirtërore, që dhurohet falas në ambientet e xhamisë së Plumbit)

I falënderova me zemër besimtarët e pranishëm dhe këshillin e xhamisë, sepse ruajtja e traditave të shëndosha fetare është obligim, që e tejkalon trendin e deformimit të gjërave në emër të ndryshimit të brezave. Sepse, përballë traditave konsensuale, nuk ka breza, ka bindje dhe pasim, nënshtrim dhe shijim të mrekullive që të falë besimi dhe zinxhiri i trashëgimisë shumëshekullore...

3) Duke bërë një shëtitje në mes të Parrucës, bashkë me një mikun tim, u ndalëm tek urimi për Ramazan, që ka vendosur Myftinia Shkodër në qendër të lagjes më të madhe muslimane të qytetit tonë.

Janë disa parulla me urime e mesazhe sensibilizuese, që kemi vendosur në vende të ndryshme të Shkodërloca tonë. Biseda na mori te tradita e Ramazanit në vendet islame. Përballë syve të mi, zburimet e Bashkisë Shkodër për festën e luleve (një transferim interesant i 6 majit, si një gjurmë pagane në thelb të festimeve tona popullore, nga ana e Bashkisë tonë), a 1 qershorin e fëmijëve, (nuk e di tamam, por nuk ka ndonjë rëndësi ky detaj), më tërhoqën vëmendjen.

I thashë edhe mikut tim, sot jemi me 21 qershor 2016, në mes të Ramazanit, në qendër të lagjeve muslimane, por nuk ka asnjë gjurmë respekti për këtë muaj nga institucionet tona, drejtuesit

e të cilëve i zgjedhim vetë ne, sikurse nuk ka asnjë biznes që të ketë afishuar një shënim me rastin e Ramazanit; një urim, një ulje çmimesh, një ofertë a të ngjashme. (Dhe thonë pastaj, se komunizmi nuk ia arriti të krijojë "njeriun e ri"!?)

M'U MBUSH ZEMRA
ME KËNAQËSI E PREKJE
TRADITASH, QË RUAJNË
ME FANATIZËM FENË
E TË PARËVE, GJURMËN E
TYRE DHE SHPIRTIN
E SHEKUJVE, QË TË LIDHIN
ME BURIMIN E DRITËS
DHE UDHËZIMIT,
HZ. MUHAMMEDIN (A.S)
DHE SAHABËT E TIJ.

Gjithsesi, tash që jam ulur të rreshtoj këto mendime e kujtime, sërish lutem për gjyshërit e mi rahmetli, (nuk e zë njeri vendin e tyre në thellësinë e qenies sime), vlerësoj shumë besimtarët frekuentues të xhamisë Dudas dhe ndjej një mosrespekt të theksuar ndaj krejt atyre që nuk e respektojnë dhe nuk e nderojnë Muajin tim të shenjtë, Muajin e shenjtë të pjesës dominuese të këtij qyteti: muslimanëve!

Për këta të fundit, do të lutem sonte, veçmas...

Shkodër, më 21 qershor 2016

FJALIMI I MYFTIUT TË SHKODRËS, IMAM MUHAMED SYTARI PËR FITËR BAJRAMIN 1437/2016

Të dashur e të shtrenjtë vëllezër dhe motra muslimanë

Falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm e të vërtetë të universit, galaktikave, detrave, maleve, njeriut dhe çdo krijese të zbuluar e të pazbuluar në historinë e gjatë të jetës mbi tokë dhe përtej saj.

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo rrahje zemre të jetës sonë, brez pas brezi, zotërisë së bijve të Ademit, Ma të Mirit e Ma të Dashtunit, Hz. Muhammedit (a.s), që u dërgua mëshirë për mbarë botët, udhëzues drejt rrugëve të Dritës së pastër të besimit, që dëbon errësirat e femohimit, politeizmit, afetarizmit dhe çdo devijimi tjetër nga burimi i origjinës njerëzore.

TË DASHUR E TË SHTRENJTË MUSLIMANË TË SHKODRËS,

O taban i qytetarisë, o trashëgues të vlerave më të mira të besimit të gjyshërve dhe baballarëve të ndershëm, që për shekuj drite drejtuan botën me mëshirë, drejtësi e tolerancë, duke mos u tutur asnjëherë nga errësira dhe njerëzit e saj, as nga hipokrizia dhe qarqet e saj, as nga injoranca dhe moçalishtet e saj, as nga bartësit e frymërave përçarëse dhe denigruese të kombit shqiptar dhe aleatët e tyre të djallëzuar!

O muslimanë të Shkodrës, që i dhuroi ymmetit islam dijetarë e shehidë, vezirë e pashallarë, hoxhallarë në frontin e mbrojtjes së qytetit nga intrigat mesjetare dhe avoketërit e tyre frikacakë, intelektualë të kalibrit botëror, që asnjëherë nuk e mohuan krenarinë e të qenit musliman dhe shqiptar!

O muslimanë të Shkodrës, që deri dje mbushët xhamitë, ju dhe fëmijët tuaj, duke kërkuar mëshirën, faljen dhe bujarinë e All-llahut të Madhëruar, në lutje e përgjërime, agjërueshëm durimtar, lexues të Kur'anit plot meditim, bamirës fisnikë, atdhetarë të shkrirë në lutje për vendin tonë të



shtrenjtë që fort lëngon, shpresues në bekimet e All-llahut Fuqiptotë dhe përkrahjes së Tij hyjnore, thirrës të sinqertë drejt fesë së Tij, Fjalës, urtisë dhe shembullit më të përsosur, që ndërton jetën me pastërti!

O muslimanë të Shkodërloces tonë të shtrenjtë, që vishet e zbukurohet çdo ditë, në pesë kohë të ndryshme me pelerinën e mëshirës dhe udhëzimit hyjnor, ezanin e teuhidit, ju uroj me zemër e me lutje të sinqerta për mrekullinë e Muajit Ramazan, që sapo u nis drejt të përtejmes për të dëshmuar për gjithësecilin prej nesh, dashuri e mall, përukje e nënshtrim për All-llahun Mëshirëplotë, që na dhuroi këtë mirësi të papërshkrueshme!

Ju uroj për sakrificën dhe besën e pathyer, për ruajtjen e amanetit dhe dëshmimin e vullnetit të shpirtave të pastër, që na lidhin ndër shekuj me thirrjen e vetme të Zotit të vetëm; Islamin tonë të shtrenjtë, Islamin e lindjes dhe të perëndimit, Islamin e çdo cepi të globit, ku thirret emri All-llah, Islamin e çdo zemre të përmalluar me përmendjen dhe dëgjimin e emrit Muhammed (a.s), Islamin, fenë e të parëve tanë të ndershëm, që i hapën zemrat All-llahut, si për të dëshmuar botërisht, nga thellësia e shekujve e deri në përjetësi: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut dhe dëshmoj se Hz. Muhammedi (a.s) është robi i Tij, i

Dërguari i Tij, në gjuhën tonë të bukur shqipe!

TË DASHURIT E MI,

Mbrëmjen që kaloi, kur hyra të fal namazin e jaxisë në xhaminë e Parrucës, më mbuloi një emocion i madh, teksa shihja xhaminë e tejmbushur me djem të rinj muslimanë, djemtë e kësaj toke, bijtë e kësaj qytetarie, që nuk e lanë besën e Ramazanit, erdhën me kokë në sexhde për të dëshmuar vazhdimësinë e rrugëtimit të gjatë me besimin dhe moralet e tij!

Ishin aty, bri njëri-tjetrit, si për të dëshmuar se kjo fé dhe ky Kur'an, se kjo kible besimi dhe kjo pastërti shpirti, sa vjen e forcohet, merr formën më të bukur, plot virtyte e cilësi, për të cilat ka nevojë vendi ynë për të shpëtuar nga greminat e injorancës, afetarizmit ekstrem, imoralitetit femohues, shthurjes së pakufi, korrupsionit vrastar, shitjes së lirë të karakterit dhe dinjitetit kombëtar, në duar të palara, që vetëm të mirën nuk i duan vendit tonë dhe të ardhmes së tij!

Ishin aty, sup më sup, për të dëshmuar bashkarisht, me krejt forcën e shpirtit, ajetin 84 të sures Ali Imran: "Thua: "Ne i kemi besuar All-llahut, edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve të tij. Edhe asaj që i është dhënë Musait

dhe Isait, edhe asaj që i është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar”!

Kjo është e vërteta e madhe e besimit dhe e fesë sonë islame, fesë së krejt të dëguarve të All-llahut, që ishin një familje e madhe, ku dominonte respekti dhe logjika, jo hilet dhe pafytyrësia për ta shkelur tjetrin, për ta cytur e për t'ia cënuar shenjtëritë e tij!

Ky është besimi ynë, për të cilin luftohemi sot, padrejtësisht, duke u etiketuar me atë çfarë nuk jemi as kemi qenë ndonjëherë, duke u cilësuar ashtu siç nuk mund të jemi kurrë, kudo qofshim, e sido qofshim, sepse ne jemi bartës të një amaneti të shenjtë shekullor, në të cilin shkruhet: “Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë, u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete...” - (Kur'ani, El-Ahzabë: 72)

TË DASHUR TË PRANISHËM,

E përmenda edhe në mesazhin e Fitër Bajramit, se Bajrami i vërtetë është atëherë, kur vendi ynë jeton në mirëqenie, në siguri, në paqe dhe harmoni, në moral e dije, në kulturë të shëndoshë dhe politika ndërtuese për shoqërinë dhe kombin, në vlera tabani dhe krenari identitare, që na bëjnë të ndjehemi krenar me vendin tonë, me tokën tonë, me emrin Shqipëri, kudo që jemi e me këdo që të jemi!

Që do të thotë se ne si muslimanë jemi të thirrur të punojmë sa më shumë për të ruajtur vlerat tona fetare dhe kombëtare, pastërtinë dhe nderin, besimin dhe moralin, sinqeritetin dhe krenarinë, kufijtë e hallallit dhe distancimin nga haramet, neglizhimin dhe distancimin nga thirrjet shterpë të krakëllimave të atyre që nuk kanë turp të përmendin “islamizimin” e shqiptarëve, si një metodë sa e vjetër, aq e re, në shfaqjet dëshpëruese islamofobike, edhe me prapaskena politike, në vendin tonë, ku laicismi selektiv i vjen erë e pështirë, sidomos në Shkodër!

TË DASHUR VËLLEZËR TË SHTRENJTË MUSLIMANË,

Sërish po e përsëris me të madhe: Jetojeni Islamin tuaj me krenari, dëshmojeni kudo shpirtin e tij, me bindje dhe forcë karakteri, me

ndërgjegje të pastër, me mëshirë për krejt krijesat e Zotit, i Cili e dërgoi të fundin e profetëve të Tij, “mëshirë për mbarë botët”!

Ju, të shtrenjtë vëllezër muslimanë, dhe ju motra të nderuara, jeni mëshirë e dhuruar, jeni paqtim garant në shoqëri, jeni mbrojtës të vlerave të tolerancës dhe dëbues me përbuzje të cinizmit mesjetar, që vret, djeg e dhunon me maskën e pabesisë mbi fytyrën katran!

Shfaqeni kudo gëzimin e Fitër Bajramit, ndajeni mirësinë në mes vete, dëbojeni shejtanin nga jeta dhe forcojeni lidhjen me All-llahun Fuqiptotë, që na nxori nga errësira e femohimit në dritën e Kur'anit dhe të Islamit, nga injoranca dhe primitivizmi, në dije e kulturë, pastërti dhe ruajtje nderi, nga humbja pas thirrjeve mbytëse, në triumf e ngadhënim, duke e bekuar jetën tonë, tokën tonë, historinë tonë, të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen tonë, me këtë Islam të mrekullueshëm, që thërret me të madhe: “E tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë.” - (Kur'ani, El-Munafikune: 8)

All-llahu ju dashtë dhe ju begatoftë jetën tuaj! Ju mbrojtë nga çdo e keqe dhe paudhësi! E begatoftë Shkodrën tonë dhe e forcoftë Islamin në zemrat e muslimanëve të saj! E begtoftë Shqipërinë tonë të shtrenjtë dhe na bëftë të respektueshëm ndaj hakut të saj në ndërgjegjen e gjithësecilit prej nesh!

All-llahu i Plotfuqishëm sjelltë paqe dhe bekime pa fund për mbarë muslimanët e botës, që kalojnë sot, ditë të vështira, në përballjen e tyre me terrorizmin, pushtimin barbar të tokave të tyre, zhatjen e pasurive kombëtare, vrasjet masive, shpërthimet deri në vendet e shenjta, torturat dhe shkeljen e të drejtave, tamam si në errësitat e barbarizmave të mesjetës së errët evropiane!

Bajrami ynë i madh është kur të kthehemi si duhet tek feja e jonë, tek Kur'ani ynë, tek krenaria legjitime islame, që na bën të jetojmë me nder dhe dinjitet, kudo që të jemi, pa iu frikësuar askujt, përveç Zotit Një!

Gëzuar Fitër Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari

Mufti i Zonës Shkodër Shkodër,
më 5 korrik 2016



"Unë shpresoj që njeriu
të JETOJË në rrugë
të All-llahut, të jetë forcë
për ymmetin e tij, t'i japë
diçka të shtrenjtë ymmetit
të tij, të përmirësojë
punën e tij, të mjaftohemi
me specializimin e tij nga
specializimet perëndimore!
Ne kemi një nevojë të
domosdoshme për të rinj që
jetojnë në rrugë
të All-llahut, sepse Islami
është vetë JETA! Sepse çdo
ajet i Kur'anit nënkupton
zbatueshmëri e, nëse ne
neglizojmë në praktikimin
e tij, do ta paguajmë
shtrenjtë!"

Dr. Rafiq Nabulsi



Hfz. Mehas Alija

Imam, B.I. "El-Hidaje", St. Gallen, Zvicër

Falënderimet dhe lëvdatat më të mëdha janë për Allahun e Madhëruar, Zotin dhe Krijuesin e të gjitha botëve. Selami dhe përshëndetjet tona qofshin për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin (a.s), mbi familjen e tij të madhe, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që jetuan me të vërtetën në zemër.

“Më i miri prej jush është ai i cili më së shumti i ruhet Allahut xh.sh.” (Huxhurat: 13).

“Xhinët dhe njerëzit, nuk i kam krijuar për tjetër, përveçse të më adhurojnë Mua.” (Dharijat: 56).

TË DASHUR VËLLEZËR,

Në Islam ka dy festa që janë shumë të rëndësishme dhe ato janë: Festa e Fitër Bajramit dhe e Kurban Bajramit. Në fenë tonë të bukur, madje edhe kur festohet, aty ka edukatë dhe rend. Aty ka veprime që konsiderohen ibadet. Bajram, në gjuhën arabe do të thotë ‘ID. Një prej kuptimeve të kësaj fjalë është edhe “kthim tek fillimi”. Kjo fjalë ka edhe kuptime të tjera, që unë do të veçoja edhe një, e që është të qenët i rehabilituar. Kjo ndodh kështu, pasi besimtarët janë njerëz, ndërsa si njerëz janë të dobët, jo të përkryer, i tillë është krijuar njeriu; besimtarët i pranojnë gabimet e tyre. Zoti ynë, Allahu Fuqiplotë, ka caktuar metoda të ndryshme se si ne të pastrohemi, se si ta largojmë barrën e gjynaheve, prandaj dhe e ka caktuar Ramazanin si një mundësi pastrimi gjeneral të trupit dhe të shpirtit. Mu për këtë mundësi pastrimi, besimtarët i gëzohen sot Bajramit të Ramazanit. Po ku kthehen besimtarët? Ata kthehen të fillimi i tyre, te gjendja fillestare e tyre, pa gjynahe e pa ngarkesa shpirtërore e psikologjike,

U GËZOFSHIN TË GJITHË MUSLIMANËT, KUDO QË JANË, ANË E KËND BOTËS

ndërkohë që janë të vendosur për të vazhduar në punë të mira dhe në rrugën e Allahut (xh.sh).

Zoti ynë na dha mundësi për t’u korrigjuar, në radhë të parë me vetë Allahun, pastaj me vetveten dhe me gjithçka tjetër që na rrethon. Na dha mundësinë për ta parë njëri-tjetrin se ku jemi, ç’veprojmë, sa jemi, si mendojmë dhe për ku shkojmë. Prandaj dhe i gëzohemi Bajramit, pasi që ky është simboli ynë i gëzimit dhe kënaqësisë për të dy botët. Ja pra, pse muslimanët agjëruan sot, ndihen të gëzuar, pasi ata sot, më së paku, ndjehen të rehabilituar dhe të relaksuar.

VËLLEZËR TË SHTRENJTË,

Sot, në këtë ditë feste, midis njerëzve ka të tillë që e ndjejnë veten fitues, dhe ashtu janë, dhe ka të tillë që e ndjejnë vetën si humbës, dhe ashtu janë. Ka fituar ai i cili, vërtetë e shfrytëzoi Ramazanin, kurse humbës është ai i cili, pa ndonjë arsye, nuk e mori vesht nëse ishte apo jo Ramazan. Ai nuk agjëroi asnjë ditë, nuk u fal asnjë ditë, nuk lexoi Kur’an asnjë ditë, nuk u pendua asnjë ditë, nuk dëgjoi asnjë ligjeratë, nuk ia zgjati dorën asnjë fukarai, e si pra të jetë ky fitues i Ramazanit? Unë kam shumë shpresë se, në këtë vend, të gjithë jemi fitues dhe krenarë me këtë Ramazan, të cilit akoma jemi duke ia dëgjuar shushurimën e këmbëve të tij, teksa po largohet prej nesh. Lamtumirë Ramazani ynë, lamtumirë dhe faleminderit që na bërë të ndjehemi fitues, sidomos në këto kohë, kur fitoret moti kohë nuk i kemi ndjerë, nuk i kemi parë!

Ramazani ishte një muaj, ku ne treguam kujdes maksimal për ta ruajtur atë, por jo vetëm. Ne treguam kujdes që, përmes agjërit, të ruajmë fenë tonë, të ruajmë mendimin e mirë për Allahun, të ruajmë identitetin tonë, sidomos në këto kohë, kur harami i ka zgjatur duart nga të katër anët për të na e vjedhur më të mirën dhe me të shtrenjtën tonë.

Vëlla i nderuar, mu ashtu sikurse u kujdese që asnjë pikë uji, pas abdesit, të mos depërtonte në fytyrën tënd, me qëllim që të ruash agjërimin tënd, të lutem, mu kështu, ruaje fytyrën dhe barkun tënd që

mos të depërtojë asnjë haram!

Vëlla i nderuar, mu ashtu sikurse u kujdese që të ruash gjuhën dhe shikimin tënd, me qëllim që të ruash agjërimin tënd, të lutem, mu kështu, ruaje zemrën dhe ahlakun tënd nga fjalët e turpshme dhe sjelljet skandaloze!

Vëllai im i madh dhe i shtrenjtë, mu ashtu sikurse që u kujdese për cilësinë e Ramazanit tënd, të lutem, mu kështu, vazhdo të kujdesesh për cilësinë e jetës dhe të besimit tënd. Ruaje këtë kualitet në raport me fenë dhe shkollën, punën dhe angazhimin, shëtitjen dhe ecjen tënde në tokë.

Në Islam ka dy festa

që janë shumë

të rëndësishme dhe ato janë:

Festa e Fitër Bajramit

dhe e Kurban Bajramit.

Në fenë tonë të bukur,

madje edhe kur festohet,

aty ka edukatë dhe rend.

Aty ka veprime

që konsiderohen ibadet.

Vëlla i nderuar, mu ashtu sikur që u kujdese maksimalisht për të mos e prishur agjërimin, të lutem, mu kështu, kujdesu që të mos e prishësh Islamin tënd dhe çerdhen e familjes tënde.

Ja pra, vëllezër të mi, këto janë qëllimet e edukimit të Ramazanit. Ai erdhi për të na dhuruar forcën dhe energjinë, që të mund të ecim me lehtësi në shtigjet e mëtutjeshme të jetës. E falënderoj pafundësisht Allahun (xh.sh) që na dha kaq shumë gjëra të bukura dhe të mira në jetën tonë, përmes kësaj feje kaq madhështore, Islami tonë.

Allahu i Lartësuar deshi që ne të shpëtojmë, ti dhe unë, në Xhennet të

IMAM DIDMAR FAJA, KËSHILLA NË PRAG TË RAMAZANIT



Me ftesë të Myftinisë Shkodër, ditën e xhuma, më 3 qershor 2016, prijësi i Qendrës së Bashkuar Islame të Arizonës, ShBA, Imam Didmar Faja, ka mbajtur hytben e xhumasë në xhaminë e Parrucës.

Në fjalën e tij, Imam Didmar Faja dha disa mesazhe dhe këshilla që lidhen me vlerën dhe madhështinë e agjërimit të Ramazanit, si një mdër adhurimet më të veçanta në Islam.

jetojmë të lumtur përgjithmonë. Kështu Muhammedi (a.s) një ditë tha: “Kush e agjëron muajin e Ramazanit, me iman dhe me shpresë, do t’i falen mëkatet e kaluara.” - (Buhari dhe Muslimi).

Allahu i Lartësuar deshi që ne sot të gëzojmë, ti dhe unë, Bajramin ta urojmë, zemrat t’i bashkojmë, krah për krah, rrugën ta vazhdojmë, lumturinë e amshueshme dhe Xhennetin ta kërkojmë...

TË DASHUR VËLLEZËR,

Bajrami është koha kur duhet të tregojmë dashuri të veçantë ndaj prindërve, fëmijëve, farefisit, fqinjve dhe miqve. Bajrami është koha kur duhet të mendojmë për të sëmurët tanë dhe ta lusim Allahun që t’i shërojë ata; të mendojmë për punëtorët dhe të lusim Allahun që t’ju ndihmojë atyre; të mendojmë për të rinjtë dhe jetimët, për të robëruarit dhe për ata që vuajnë dënime, të mendojmë për të gjithë ata njerëz me zemra të mira që Allahu t’i ruaj prej çdo belaje dhe ngarkese. Bajrami është koha kur duhet të mendojmë për forcimin e lidhjeve tona vëllazërore, për shkak se ato janë të ndjeshme dhe

Imami i nderuar iu referua haditheve të shumta, prej ku vlerësohet sakrifica e besimtarëve dhe shpërblimi që do të marrin në këtë jetë dhe në të ardhmen.

Gjatë hytbes së tij, Hoxha i nderuar shkodran me aktivitet në ShBA dhe Meksikë, tha se një numër i madh personash në shtete të ndryshme të Amerikës dhe në Meksikë, po interesohen për Islamin dhe po e pranojnë si fenë e tyre.

prishen shpejt. Islami dhe kombi ynë ka nevojë për bashkimin e zemrave tona, ashtu siç kanë nevojë zemrat tona të afrohen me njëra-tjetrën.

Nuk do të ishte e hijshme po ta përmbyllnim këtë hytbe pa i kujtuar me lutje edhe vëllezërit dhe motrat e mbarë botës islame, sidomos ata në Egjipt, Siri, Libi, Palestinë, Kinë, Burma, Turqi, etj. Allahu u ndihmoftë dhe i çliroftë prej çfarëdo lloji zullumi dhe padrejtësie.

Në fund, të dashur vëllezër, të gjithë juve nga zemra ju uroj festën e Fitër Bajramit, duke e lutur Allahun për shendetin dhe suksesin tuaj në jetë dhe në punë. Gjithashtu, në emër të kryesisë së xhamisë dëshiroj që t’ju përcjell mesazhin e urimit të gjithë ju të pranishëm dhe farefisit tuaj, kudo qoftë ai: në Zvicër, Kosovë, Preshevë, Maqedoni, Shqipëri, Bosnjë, Mal të Zi, apo në ndonjë vend tjetër.

Urime edhe njëherë Festa e Fitër Bajramit dhe u gëzofshin të gjithë muslimanët, kudo që janë, anë e kënd botës.

(Hytbeja e Fitër Bajramit, 2016, Xhamia "El-Hidaje", St. Gallen, Zvicër)



I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S)
KA THËNË:

“Allahu i Lartësuar
ju ka bërë obligim
agjërimin e Ramazanit,
ndërsa unë ju kam bërë
synet namazin e tij
(teravinë). Kështu që,
kush e agjëron
Ramazanin dhe falë
teravinë, me besim,
me bindje
dhe vendosmëri, ai
njeri del nga Ramazani
i pastër nga gabimet,
si ditën që e ka lindur
nëna e tij.”

(Transmetuar nga Nesaiu)

MIJËRA KOPJE TË KUR'ANIT NË PRAG TË RAMAZANIT 1437

Paraditën e të xhumasë, më 3 qershor 2016, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Qendrën Islame Shqiptare “El-Buhari”, Vjenë, ka bërë të mundur shpërndarjen e kopjeve të shumta të Kur'anit Famëllartë me përkthim të kuptimeve në gjuhën shqip.

I pranishëm në “Çadrën e Ramazanit”, ka qenë edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili ka vlerësuar se shpërndarja e përkthimit të Kur'anit në shqip, është një mundësi më shumë që qytetarët e Shkodrës ta lexojnë Fjalën e Zotit, ta kuptojnë atë dhe të marrin nga mirësia dhe vlerat e larta shpirtërore që burojnë prej saj.

Myftiu theksoi se aktiviteti i sotëm është i pari i një maratone të gjatë me aktivitete, tribuna, sofra bamirësie, iftare, emisione



televizive, botime, promovime, vizita, takime, derse, adhurime, lutje e tubime, inaugurime, ndërtime të reja etj, me rastin e Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit.

Ditën e sotme u shpërndanë edhe mijëra kalendarë të Ramazanit të sivjetshëm, broshura udhëzuese mbi rregullat e agjërit, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, broshura me disa porosi profetike etj.

Shpërndarja e Kur'anit do të vijojë edhe në ditët e Ramazanit në disa nga zonat muslimane të Shkodrës.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen e saj për Qendrën Islame Shqiptare “El-Buhari”, Vjenë dhe kontributin e saj për gjallërimin e vlerave të Thirrjes Islame në Shkodër.



INSPEKTOHET XHAMIA E RE NË FSHATIN SHTOJ I RI



Me mbarësinë e All-llahut, shumë shpejt përfundojnë punimet për inaugurimin e xhamisë së re në fshatin Shtoj i Ri.

Xhamia e re, e punuar me shije, është pa dyshim një kompleks i ri besimi, ku besimtarët e kësaj zone do të kenë mundësinë të kryejnë rregullisht adhurimet dhe aktivitetin e tyre fetar, duke shijuar edhe kënaqësitë e ambientit të ri.

Ditën e shtunë, më 4 qershor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga imami i xhamisë Shtoj i Ri, Abdullah Duraj, inspektoi nga afër punimet e kryera në xhaminë e re,

që tashmë ka marrë formën dhe pamjen e një kompleksi të bukur dhe mjaft tërheqës islam.

Minarja e re, penxheret e zbukuruara nga dora e piktorëve të rinj, punimet e drurit, minberi dhe mihrabi, mafili i grave, klasa për kurset e mësim-besimit, abdeshanja e hapur, oborri i shtruar dhe pemët frutore të mbjella përreth, i japin një bukuri të veçantë kësaj xhamie të re.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen e saj për donatorin bamirës, imamin e xhamisë, këshillin e saj, grupin e punës dhe të gjithë ata që kontribuan për këtë vepër besimi!



*"Pasha All-llahun
nuk keni rrugë tjetër
drejt unifikimit,
pos Kur'anit, pos parimit
të Hz. Muhammedit (a.s.),
edhe parimit të Khalid ibnel-
Velidit, të Seadit, të Tarikut,
të Kutejbes, të Salahuddinit..."*

Shejkh Ahmed Keftaro

Me këndimin e ezanit të akshamit të ditës së dielë, më 5 qershor 2016, është sinjalizuar edhe hyrja e Hënës së re të Muajit Ramazan 1437.

Kështu, nata e parë e teravisë ka tërhequr drejt xhamive të Shkodrës besimtarë të shumtë, që kanë nisur kështu adhurimet e natës së parë të Ramazanit të sivjetshëm, agjërimi i të cilit fillon ditën e hënë, më 6 qershor 2016.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, këtë vit zgjodhi xhaminë e re të fshatit Kullaj, si stacionin e tij të parë të namazit të teravisë.

Ndonëse nuk është inauguruar ende, xhamia e re në fshatin Kullaj ka hapur sonte dyert e fatoes së saj për besimtarët muslimanë, që prej shumë kohësh e kanë pritur këtë ditë të gëzuar.

Myftiu mbajti edhe një bisedë fetare, ku vuri theksin te vlerat e mëdha të agjërit dhe muajit Ramazan, si dhe veçoritë, me të cilat Zoti i gjithësisë ka dalluar ymmetin islam nga popujt e tjerë.

XHAMITË E SHKODRËS HAPIN DYERT PËR NAMAZIN E TERAVISË



I pranishëm në faljen e teravisë në xhaminë e re në Kullaj ishte edhe Imam Didmar Faja, prijës i Qendrës së Bashkuar Islame të Arizonës. Në fjalën e tij para xhematit, imami i nderuar këshilloi të pranishmit që ta vlerësojnë mirësinë e kësaj xhamie

dhe të punojnë për ruajtjen dhe konsolidimin e unitetit dhe vëllazërisë islame në mes vete.

Namazi i teravisë është një traditë profetike e veçantë për muajin Ramazan. Teravia falet pas namazit të jacisë dhe ka njëzet rekate.





Pasditën e së martës, më 7 qershor 2016, Myftinia Shkodër organizoi në ambientet e bibliotekës së qytetit, promovimin e librit me titull: “Shpjegimi i dyzet e dy thënieve profetike”, nga i nderuari Imam Didmar Faja.

Në këtë promovim morën pjesë intelektualë të qytetit, mësues të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, imamë e teologë, familjarë e të afërm të autorit, miq e dashamirë të librit, që kishin tejmbushur sallën e aktivitetit në fjalë.

Fillimisht, thirrësi islam Lavdrim Hamja lexoi një jetëshkrim të autorit, ku spikat aktiviteti i tij i dendur në shërbim të Thirrjes Islame në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Meksikë, botimet e ndryshme, ligjëratat fetare etj.

Një vështrim mbi librin dhe vlerat e tij, ishte referati i mbajtur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u ndal te rëndësia e veprës së Imam Neveviut, 40 hadithet e përzgjedhura, si dhe shpjegimet, komentimet e analizat e shumta që i janë bërë këtij libri ndër shekuj.

Myftiu theksoi se ky shërbim i bërë nga Imam Didmar Faja i sjell dobi bibliotekës islame në gjuhën shqipe dhe e pasuron atë.

Një vështrim mbi detaje të këtij botimi e bëri edhe teologu Arben

PROMOVOHET LIBRI I RI NGA IMAM DIDMAR FAJA



Halluni, i cili mbajti një referat, duke u përqendruar te vlera e 40 haditheve dhe morali i tyre për individin musliman dhe shoqërinë në përgjithësi.

Me shumë kënaqësi u prit fjala e autorit, i cili u ndal te katër pika të rëndësishme, që e shtynë drejt kësaj vepre plot dobi. Fillimisht, dashuria për të dërguarin e All-llahut, pastaj dëshira për të nxjerrë në pah vërtetësitë e fesë islame në këtë kohë trazirash, dëshira e mirë për t'u mësuar këto hadithe në masë dhe shpjegimi i tyre në gjuhën shqipe.

Imam Didmar Faja foli edhe për sfidën e mosdijes dhe keqleximit dhe

keqinterpretimit të fesë, por edhe për numrin e madh të perëndimorëve që po hyjnë në Islam, sidomos pas leximeve të thelluara dhe bindjes se realitetet e sotme ku dër Islamit, nuk kanë lidhje me thelbin e fesë, as me vërtetësitë e tij.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga H. Fejzi Zaganjori i cili tha se kontributi i nderuarit Imam Didmar Faja, është vlerë e shtuar në shërbimet e hoxhallarëve shqiptarë në diasporë ndaj kombit dhe shqiptarizms.

Në fund të aktivitetit, për pjesëmarrësit u shpërnda falas libri i ri i promovuar.

Paraditën e së dielës, më 12 qershor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të ngrohtë e vëllazëror, z. Jaser Al-Bader, Atashe diplomatik pranë Ambasadës së Kuvajtit në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte urimi me rastin e Ramazanit 1437/2016 dhe shpërndarja e pakove ushqimore për personat në nevojë, projekt bamirës që ambasada e Kuvajtit e praktikon prej vitesh në qytete të ndryshme të vendit tonë.

Myftiu e falënderoi z. Al-Bader për përkushtimin dhe interesimin e vazhdueshëm të ambasadës së Kuvajtit për realizimin e projekteve bamirëse në fusha të ndryshme, duke përhapur mirësi dhe vlera, sidomos në muajin e madhërueshëm të Ramazanit.

Nga ana e tij, z. Al-Bader theksoi se ndihma ndaj të varfërve dhe njerëzve në nevojë ka një rëndësi të madhe, sidomos në këtë Muaj, por edhe në dëshmimin e

AMBASADA E KUVAJTIT NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË



vëllazërisë dhe solidaritetit në mesin e dy popujve tanë.

Një pjesë e pakove të Ramazanit, u shpërndanë në prezencë të Myftiut

dhe Atasheut, të cilët uruan që ky projekt bamirës të vazhdojë edhe në të ardhmen, në dobi të familjeve shkodrane në nevojë.

“PAKOJA E RAMAZANIT”, NDIHMA PËR FAMILJET NË NEVOJË

Ditën e hënë, më 13 qershor 2016, Myftinia Shkodër ka nisur zbatimin e projektit “Pakoja e Ramazanit”, duke ndihmuar qindra familje besimtare në nevojë, në këto ditë të Ramazanit.

Në krye të zbatimit të këtij projekti, z. Lavdrim Hamja, ka sqaruar se këto ndihma janë përcaktuar për familjet në nevojë nga xhamatet e xhamive të ndryshme të Shkodrës, në qytet e fshat dhe se ky projekt do të zbatohet në koordinim me imamët e xhamive tona.

Nëpërmjet këtij projekti, Myftinia Shkodër synon ardhjen në ndihmë të familjeve besimtare në nevojë, duke kontribuar për një muaj agjërimi sa më të mbarë e të lehtë.

Pas përfundimit të listave dhe plotësimit të pakove me ushqime, ka nisur sot zbatimi i këtij projekti bamirës, që do të vijojë gjatë gjithë muajit Ramazan.



INSPEKTOHEN VAKËFET PËR DY XHAMI TË REJA

Ditën e hënë, më 13 qershor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka inspektuar nga afër vendet, ku do të nis puna për ndërtimin e dy xhamive të reja; në Bërdicë të Mesme dhe në Shtuf.

Pas miratimit të bërë nga Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pritet që të fillojnë punimet për dy xhamitë e reja, në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC).

Myftiu dhe stafi i tij, sëbashku me përfaqësuesin e AIITC, z. Rasim Zekaj, panë nga afër hapësirat e mundshme për zbatimin e dy projekteve të reja, që do të mundësojnë zbulimin e Shkodrës edhe me dy xhami të reja, shumë të nevojshme për besimtarët muslimanë.

Me mbarësinë e All-llahut, Myftinia Shkodër, ju fton të merrni pjesë në hedhjen e themeleve për xhaminë e re në fshatin Bërdicë e Mesme, ditën e xhuma, më 17 qershor 2016, ora: 12.00.

MBRËMJE E BEGATË FETARE NË XHAMINË E PLUMBIT



Ditën e enjte, më 16 qershor 2016, Myftinia Shkodër organizoi një Mbrëmje Fetare të ngjeshur me adhurime, lutje, ligjërata, këshilla fetare dhe përsëritje në Xhaminë e Plumbit.

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kur'anore nga H. Ibrahim Aslan, i ardhur këtë Ramazan nga Turqia, për shërbim në Shkodër.

Më pas, teologu Arben Halluni uroi pjesëmarrësit për këtë ditë të agjëritit dhe theksoi se tubimi pranë Xhamisë së Plumbit ka një simbolikë të veçantë për besimtarët muslimanë të Shkodrës. Ai tha se ky tubim është një risi e Myftinisë Shkodër, duke u nisur nga programi i larmishëm, ligjëratat, iftari i hapur, namazi i akshamit dhe pjesa që e pason deri në faljen e namazit të jacisë me teravinë.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili shprehu kënaqësinë e tij për këtë mbrëmje besimi, për iftarin vëllazëror në oborrin e tokës së begatë të Xhamisë së Plumbit.

Myftiu dha disa mesazhe, duke u përqendruar te domosdoshmëria e reflektimit të muslimanëve shqiptarë, për të parë se çfarë pasojash i solli vendit tonë dekadencia komuniste dhe politikat aktuale të deformimit të moralit, degradimit shoqëror, skamjes e varfërit të shoqërisë, duke e luftuar besimin dhe fenë me metoda të reja.

Myftiu ftoi të pranishmit të luten dhe të punojnë fort për Thirrjen Islame, duke u kthyr në thirrës që nuk tundohen as frikësohen për të ftuar shoqërinë drejt besimit dhe fesë islame, si shërim garant për lëngatat e shumta të saj.

Në program ishin rezervuar edhe dy ligjërata fetare, që u mbajtën nga H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe dhe Hafiz Ensar Ismailaj, i diplomuar i teologjisë në Universitetin e Medines.

Ligjëruerit dhanë mesazhe të urta e të dobishme, që lidhen me përfitimin nga

agjërimi i Ramazanit dhe hapjen e derve të zemrës ndaj thirrjes së All-llahut të Madhëruar në jetë.

Para kohës së iftarit, H. Yakup Avcı, i ardhur nga Turqia, lexoi një pjesë kur'anore dhe këndoi ezanin e akshamit të kësaj dite të begatë.

Pas iftarit në shesh, H. Fejzi Zaganjori bëri një lutje, duke kërkuar bekime e begati për besimtarët agjëruar, Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë ymmetin islam.

Pas faljes së akshamit me xhamat, të pranishmit kaluan disa momente të këndshme, shoqëruar nga biseda vëllazërore, bashkëbisedime, pyetje-përgjigje me imamët e pranishëm.

Me shumë emocion u ndoq dokumentari me rastin e 25 vjetorit të rihapjes së Xhamisë së Plumbit, ku u dëgjua plot kumbim zëri i Hafiz Sabri Koçit, emocionet e H. Faik Hoxhës, H. Faik Zaganjorit, H. Xhelal Sokolit, H. Mithat Myftisë etj.

Aktiviteti u pasua nga ligjërata e teologut Lavdrim Hamja, i cili hodhi dritë mbi vlerën e kthimit nga All-llahu i Madhëruar, me përulje, dashuri e dinjitet. Imamimi nderuar theksoi se edukata dhe urtësia janë dy cilësi të besimtarit, në rrugëtimet e tij drejt Zotit.

Pas ligjëratës, Myftiu i Shkodrës bëri një falënderim për ekipin e Myftinisë Shkodër dhe të pranishmit, për emocionet e përjetuara në këtë natë dhe mbarësinë e këtij aktiviteti risi.

Ezani i jacisë u këndua nga teologu i nderuar, Alban Kali, i cili ftoi besimtarët për namazin e fundit të ditës dhe atë të teravisë, që u fal me xhamat nën drejtimin e H. Ibrahim Aslan.

Me rastin e kësaj Mbrëmjeje Fetare, Myftinia Shkodër shpërndau për të pranishmit edhe botimin e saj më të ri, titulluar: “25 vjetori i një dëshmie historike”, si dhe një kopje të Kur'anit me përkthim të kuptimeve në gjuhën shqipe, mundësuar nga Qendra Islame Shqiptare “El-Buhari” në Vjenë të Austrisë.

Mbrëmjen e së martës, më 14 qershor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga një grup imamësh të Myftinisë Shkodër, mori pjesë në iftarin vëllazëror të shtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Prizrenit.

Me këtë rast, Myftiu uroi Kryetarin e ri të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mr. Besim Berisha, të cilit i uroi suksese dhe mbarësi në detyrën e re. Njëkohësisht i konfirmoi vullnetin e bashkëpunimit dhe domosdoshmërinë e angazhimeve të përbashkëta në dobi të interesit të Thirrjes Islame dhe vlerave më të mira islame e kombëtare.

Nga ana e tij, Mr. Besim Berisha, e falënderoi Myftiun me imamë, për pjesëmarrjen në iftarin vëllazëror, në mesin e imamëve të Prizrenit. Njëherazi, konfirmoi

IFTAR VËLLAZËROR NË MESIN E IMAMËVE TË PRIZRENIT



vullnetin e bashkëpunimeve të mëtejshme, në rrugën e ruajtjes dhe forcimit të frymës së harmonisë dhe vëllazërisë islame në mesin e dy institucioneve.

Myftiu i Shkodrës mbajti edhe një fjalë para të pranishmëve, ku uroi Muajin Ramazan dhe bëri thirrje për të ruajtur vlerat e harmonisë dhe vëllazërisë në mes vete.

CEREMONIA E NISJES SË PUNIMEVE PËR XHAMINË E RE NË BËRDICË

Ditën e xhuma, më 17 qershor 2016, u zhvillua ceremonia simbolike e përcaktimit të kibles dhe fillimit të punimeve për xhaminë e re në fshatin Bërdicë e Mesme.

Myftinia Shkodër dhe Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC), u angazhuan për të mbërritur në këtë ditë të lumtur për mbarë komunitetin.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, përfaqësuesi i AIITC, z. Alban Kodra, administratori i zonës, z. Aleksandër Pashuku, imamë dhe dhe besimtarë të zonës, që ndanë bashkarisht mesazhet uruese me rastin e këtij momenti të gëzuar për fshatin dhe mbarë bashkësinë islame të Shkodrës.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër, shpreh falënderimet e saj për AIITC, administratën e zonës Bërdicë, Bashkinë Shkodër dhe në mënyrë të veçantë për Kryesinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për miratimin e fillimit të punimeve për këtë xhami të re në këtë Muaj të begatë të Ramazanit.

Ditën e hënë, më 20 qershor 2016, Myftinia Shkodër organizoi një Mbrëmje Fetare, në thelb të së cilës ishte promovimi i botimit më të ri me titull: “40 hadithe rreth mirësisë së Kur’anit”, nga autori Ahmed El-Ankarij, përkthyer në shqip nga teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”.

Aktiviteti u hap me fjalën e rastit nga teologu Arben Arben Halluni, i cili vlerësoi kontributin e teologut Lavdrim Hamja dhe theksoi se Muaji i Ramazanit është momenti më i përshtatshëm për daljen në shqip të këtij botimi mbi vlerën e Kur’anit.

Një ligjëratë me temë: “Rëndësia e të jetuarit me Kur’an në jetën e muslimanit”, u mbajt nga Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Shkodrës.

Ndër të tjera, Myftiu theksoi se: “muslimani që e vlerëson Fjalën e Zotit në jetë, jeton paqësisht me Zotin, me veten, me tjetrin, (kushdo qoftë tjetri). Këtë model muslimani e karakterizon humanizmi, mëshira, dinjiteti, krenaria, pastërtia, adhurimi, drejtësia, nderi!

Për këtë, thotë në Kur’anin Famëlartë: “Atyre, të cilëve u dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejtë ashtu si është, ata e besojnë atë (Kur’anin). E ata që e mohojnë atë, të tillët janë ata që dështuan (në dynja e në ahiret).” – (Kur’ani, El-Bekare: 121)

Leximi i drejtë nuk nënkupton

U PROMOVUA LIBRI ME 40 HADITHE MBI VLERËN E KUR’ANIT



texhvidin, idgamin e idhharin e tij, por praktikimin e tij në jetë. Sepse, kur e lexon si duhet recetën e mjekut, vrapon të blesh ilaçet. Por, nëse e lexon recetën me gjuhë letrare, madje paguan edhe një aktor për ta recituar dhe interpretuar atë, por pa i marrë ilaçet, as shëroresh, as konsiderohesh njeri normal në veprimin tënd!”

Ndërkohë, përkthyesi i librit, teologu Lavdrim Hamja, në fjalën e tij, theksoi se shtysa kryesore që e ka nxitur të shërbejë

këtë punë është dëshira e madhe që njerëzit të kuptojnë madhësitinë e Kur’anit, rëndësinë e mësimin të tij dhe përhapjes së vlerave të tij kudo.

Ai tha se realitetet e sotme po na imponojnë përherë e më shumë angazhimin e vazhdueshëm për t’i shërbyer Fjalës së All-llahut dhe mësimave të Tij.

Për të pranishmit u shtrua edhe iftari inkësaj dite Ramazani, sikurse u dhurua libri i ri me 40 hadithe mbi mirësinë e Kur’anit Famëlartë.

CEREMONIA E FILLIMIT TË PUNIMEVE PËR XHAMINË E RE NË FSHATIN SHTUF



Ditën e xhuma, më 24 qershor 2016, U zhvillua ceremonia simbolike e fillimit të punimeve për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Shtuf, Ana e Malit.

Xhamia e re vjen si bashkëpunim i Myftinisë Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam.

Xhamia e re po ndërtohet mbi vakëfin e dhuruar nga z. Arfi Hoxha, që pati mirësinë të bëjë këtë bamirësi të madhe për komunitetin, pikërisht në Muajin Ramazan, ku edhe shpërblimi i All-llahut për vepra të tilla shumëfishohet.

Ceremonia u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, nga Administratori i Njësisë Administrative Ana e Malit, z. Arben Ceni, si dhe z. Alban Kodra, përfaqësues i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam.

Pas përcaktimit të kibles, Myftiu bëri duanë e rastit dhe uroi mbarësi për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Shtuf, Ana e Malit.

NJË MBRËMJE FETARE VËLLAZËRORE NË ZOGAJ

Në kuadër të aktiviteteve me rastin e Muajit Ramazan 1437/2016, Myftinia Shkodër organizoi një Mbrëmje Fetare në xhaminë e lagjes Zogaj.

I pranishëm ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili iu drejtua të pranishmëve me një këshillë fetare.

Më parë, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, mbajti një fjalë, dha disa udhëzime të dobishme për shfrytëzimin e duhur që duhet t’i bëjmë ditëve të mbetura të Ramazanit.

Të pranishmit kaluan momente të këndshme edhe në shoqërinë e bashkëbisedimeve

vëllazërore, iftarit të përbashkët dhe namazit të akshamit me xhemat.



Ditën e shtunë, më 25 qershor 2016, Myftinia Shkodër dhe Fondacioni “Mirësia”, organizuan një iftar vëllazëror me xhematin e xhamisë së lagjes Dudas, si pjesë e bamirësisë së donatorit të kësaj xhamie, me rastin e Muajit Ramazan.

Këtë tubim të e begatë e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, si dhe Drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja.

Gjatë fjalimeve të rastit, u theksua vlera e madhe që ka Ramazani, si një sistem i paqhtë, që i afron përherë e më shumë muslimanët me njëri-tjetrin dhe nxit bamirësinë, altruizmin dhe harmoninë në komunitet.

U theksua gjithashtu se tubime të tilla, kanë një vlerë të madhe në respektimin e simbolikave të fesë, siç është edhe agjërimi i Ramazanit.

NJË IFTAR VËLLAZËROR ME XHEMATIN E XHAMISË DUDAS



Të pranishmit kryen sëbashku edhe namazin e akshamit me xhemat, si dhe

ndanë urimet dhe lutjet e përbashkëta me rastin e kësaj nate të begatë.

Ramazani i sivjetshëm ka ardhur me shumë begati e mirësi për muslimanët e Shkodrës. Aktivitete të larmishme, iftare vëllazërore, bamirësi të shumta, qindra familje shkodrane të ndihmuara në mënyra të ndryshme, të rinj të shumtë agjërues, fëmijë që prezantojnë faljen e sabahut me xhemat, shtimi i Hatmeve Sherife në xhamitë tona, nisja e punimeve për xhami të reja, e shumë e shumë mirësi të tjera.

Pa dyshim, një ndër risitë e bukura të këtij Muaji të begatë, janë edhe vizitorët e nderuar që po e gjallërojnë edhe më shumë aktivitetin fetar dhe atmosferën e Ramazanit në Shkodër.

Janë pjesë e bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me Dijanetin e Turqisë dhe atë të Arabisë Saudite.

Kështu, gjatë gjithë Ramazanit, Myftinia Shkodër ka mirëpritur dy hafizët e ardhur nga Turqia, të nderuarit, Hfz. Ibrahim Aslan dhe Hfz. Yakup Avcı.

Ndërkohë, ditën e djeshme nderoi me vizitën e tij, Dr. Mahmud Esh-Shinkiti, nga Arabia Saudite, ndërsa sonte, namazi i teravisë në xhaminë e Parrucës u drejtua nga dy hafizët e nderuar, Hfz. Yusuf Sulejmanogllu dhe

VIZITORË TË NDERUAR NGA ARABIA SAUDITE DHE TURQIA



Hfz. Abdurrahman Tavor, që shërbejnë këtë Ramazan në qytetin e Elbasanit.

Myftinia Shkodër falënderon vizitorët e nderuar dhe shpreson që

bashkëpunime të mëtejshme me botën islame të sjellin shtimin e thirrësve islamë joshqiptarë në vendin tonë, si miq të shumëpritur dhe të nderuar.

Ditën e xhuma, më 1 korrik 2016, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë e lutjes së Hatmes Sherife, në prag të Natës së Kadrit.

Aktiviteti, që mblodhi shumë besimtarë në sofrën e Kur'anit Famëllartë, nisi me një këshillë fetare nga teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave".

Në fjalën e tij, imami i nderuar tha se leximi i Kur'anit është traditë profetike dhe një angazhim që na mban të lidhur përherë me shpirtin e besimit dhe praktikimin e tij.

Më pas Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi imamët e angazhuar me leximin e krejt Kur'anit, gjatë ditëve të këtij Ramazani. Ai falënderoi në mënyrë të veçantë dy hafizët nga Turqia, që ishin shembulli i imamit të përkushtuar, sisomos në leximin e Kur'anit dhe drejtimin e namazeve të teravisë.

Myftiu ftoi të pranishmit dhe përtej tyre që ta lexojnë Kur'anin dhe ta gjallërojnë jetën me dritën e tij.

Aktiviteti kulmoi me leximin e

LUTJA E HATMES SË KUR'ANIT TEJMBUSH XHAMINË E PARRUCËS



njëzet sureve të fundit të kësaj Hatmeje Sherife, që u mbyll me lutjen e gjatë në gjuhën shqipe nga Myftiu i Shkodrës.

Të pranishmit u lutën për besimin, mirëqenien, harmoninë dhe vëllazërinë në mesin e muslimanëve, forcimin e muslimanëve në realitetet shqiptare

dhe pranimin e adhurimeve, agjërimit, namazeve, sadekave etj.

Aktivitetet e Natës së Kadrit do të vazhdojnë edhe këtë mbrëmje, pas namazit të jaxisë e deri në prag të syfyrit, në xhaminë e Parrucës dhe në të gjitha xhamitë e Shkodrës.

Të xhumanë, më 1 korrik 2016, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u zhvilluan lutje dhe adhurime, me rastin e Natës së Kadrit.

Pas namazit të jacisë e deri në kohën e namazit të sabahut, u organizuan biseda fetare mbi vlerën dhe madhësinë e Natës së Kadrit, mexhlise dhikri, salavate, adhurime individuale e me xhematë, lutje e përgjërime drejtuar All-llahut, Zotit të vetëm të gjithësisë.

Ceremonitë fetare të kësaj Nate mblodhën shumë të rinj e të reja përreth xhamive tona, që dëshmuar shpirtin e besimit të rinisë tonë muslimane.

Me rastin e kësaj Nate të Madhe, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një mesazh urimi për krejt ymmetin islam, drejtpërdrejt nëpërmjet njërit prej kanaleve sociale live të televizionit Al-Jazeera.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen e saj për krejt besimtarët që morën pjesë në këto ceremoni, si dhe vlerëson maksimalisht praninë e madhe të rinisë në xhami, si një shenjë bekimi për Shkodrën dhe shoqërinë tonë!

ADHURIME DHE LUTJE NË NATËN E KADRIT



Ditën e shtunë, më 2 korrik 2016, në atmosferën e Natës së Kadrit, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin "Mirësia", organizuan në xhaminë e Mjedës, konkursin e hifzit të Kur'anit Famëlartë, me disa nivele.

Në këtë konkurs morën pjesë nxënës të disa prej kurseve fetare të xhamive të Myftinisë Shkodër.

Në një atmosferë të begatë, në prani edhe të imamëve të nderuar të xhamive pjesëmarrëse, nxënësit prezantuan përgatitjen e tyre, duke shfaqur rezultate mbresëlënëse dhe duke dëshmuar përpjekje të lavdëruara në mësimin përmendësh të Kur'anit Famëlartë.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe nga Drejtori i Fondacionit «Mirësia», z. Korab Kaja.

Për fituesit e konkursit dhe krejt të pranishmit u shpërndanë dhurata, me lutjen e vazhdimësisë në këtë rrugë të mbarë.

KONKURS HIFZI I KUR'ANIT FAMËLARTË



IFTARI TRADICIONAL I MYFTINIVE SHKODËR, PRIZREN DHE ULQIN



Mbrëmjen e së shtunës, më 2 korrik 2016, Myftinia Shkodër organizoi iftarin e përvitshëm me përfaqësues të bashkësive islame të Prizrenit, Ulqinit, këshilltarët e saj, miq e kontribues të ndryshëm në shërbim të vlerave islame në qytetin e Shkodrës dhe përtej.

Të pranishëm në këtë sofër bujare ishin edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Bruçaj, rektori i Universitetit "Bedër", Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Besim Ef. Berisha, Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Ulqinit, z. Gazmend Dollaku, antarët e Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Dr. Genti Kruja dhe z. Uran Kalej, Drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, intelektualë të njohur të qytetit, imamë, teologë, biznesmenë, përfaqësues të shoqatave islame etj.

Në prag të iftarit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi të pranishmit për agjërimin e kësaj dite dhe theksoi se sofrat tilla janë simbolika të

bashkëpunimit, harmonisë dhe lidhjes së singertë në mesin e muslimanë, që janë të thirrur të ndërtojnë jetën me sinqeritet dhe besim.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe Kryetari i KMSH-së, H. Skender Bruçaj, i cili theksoi se organizime të tilla ja shtojnë kuptimin dhe vlerat atmosferës njëmuje të Ramazanit, si një muaj që afron përherë e më shumë me vlerat e besimit dhe virtytet më të larta njerëzore.

Një përshëndetje të ngrohtë erdhi edhe nga Kryetari i KBI të Prizrenit, Besim Ef. Berisha, i cili shprehu kënaqësinë e tij për praninë në Shkodër, në këtë sofër bujare, ku dominojnë vlerat e harmonisë dhe vëllazërisë islame.

Në emër të KBI Ulqin përshëndeti Suad Ef. Ukoshata, që falënderoi organizatorët dhe shprehu kënaqësinë e këtij organizimi vëllazëror.

Iftari i bashkëpunimit në mesin e tri bashkësive islame, Shkodër, Prizren, Ulqin, po kthehet në një traditë të bukur me vlera islame dhe kombëtare.



"O zotërinj! Përse po përqaheni? A nuk i shikoni duart, të cilat duan t'ju hedhin në humnerë e t'ju mbulojnë me dhe?"

A nuk e dëgjoni fjalën e Allahut që ushtin në veshët tuaj: "Me të vërtetë ky është ymeti juaj, një ymet i vetëm dhe Unë jam Zoti juaj e Mua më adhuroni" (El-Enbija: 92).

A nuk e dëgjoni premtimin dhe kërcënimin e Tij që ju thotë: "Nëse ia ktheni shpinën (largoheni), sjellë një popull tjetër nga ju, e pastaj ata nuk janë si shembulli juaj" (Muhammed: 38).

Dr. Mustafa Mahmud

Ditën e diel, më 3 korrik 2016, me këndimin e ezanit të jacisë, në të gjitha xhamitë e Shkodrës nisi edhe falja e namazit të teravisë së fundit për Ramazanin 1437.

Namazi i teravisë është një falje e veçantë e netëve të Ramazanit. Teravia ka njëzet rekate, që falen me xhemat, si një traditë e fortë profetike.

Në xhaminë e Parrucës ishte i pranishëm edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili uroi muslimanët për agjërimin e deritanishëm dhe namazin e teravisë. Myftiu theksoi se agjërimi i Ramazanit ishte një mundësi e madhe për t'u kthyer në origjinën e besimit dhe krenarisë islame, që duhen bartur si një amanet i shenjtë sa të jemi në jetë.

Më pas, Myftiu, teologu Naim Drijaj dhe teologu Gezim Dungaj, drejtuan namazin e jacisë, teravinë dhe vitrin e kësaj nate të begatë.

Myftinia Shkodër ju uron adhurime të pranura, agjërim të lehtë të ditës së fundit të këtij Ramazani, sikurse njofton se dita e parë e Fitër Bajramit 1437/2016, është ditën e martë, më 5 korrik 2016.

Falja e Sabahut dhe Fitër Bajramit do të bëhet në sheshin e Namazgjasë, bri xhamisë «Ebu Bekër», duke nisur nga ora: 4.30. Bajrami falet në orën: 06.02.

Muslimanët e Shkodrës falën teravinë e fundit të Ramazanit 1437



Që në orët e para të mëngjesit të ditës së martë, më 5 korrik 2016, në sheshin e Namazgjasë, bri xhamisë së Fushë Çelës, mijëra besimtarë muslimanë të Shkodrës, iu bashkangjiten organizimeve të Fitër Bajramit të këtij viti, në një atmosferë të mrekullueshme besimi dhe harmonie islame.

Ceremonia nisi me faljen e namazit të sabahut, nën drejtimin e teologut Idmir Plaku. Më pas, dy hafizët e ardhur nga Turqia, H. İbrahim Aslan dhe H. Yakup Avci, lexuan disa pjesë kur'anore.

Programi i ceemonisë u prezantua nga teologu Arben Halluni, i cili uroi të pranishmit me rastin e Fitër Bajramit dhe u lut për praninë të agjërimin të njëmuji të Ramazanit.

Në vazhdim, u mbajtën ligjërata, këshilla fetare, lutje dhe mesazhe nga teologu Naim Drijaj dhe teologu Lavdrim Hamja, që folën mbi rëndësinë dhe vlerën e vazhdueshmërisë në rrugën e adhurimeve dhe përsosjes së moralit islam, si dhe vlerën e madhe që ka studimi i Kur'anit, si burimi kryesor i udhëzimit të miliona njerëzve në mbarë

FITËR BAJRAMI, TRADITË BESIMI POPULLORE NË SHKODËR



botën.

Një mesazh dha edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili uroi të pranishmit e shumë me rastin e Fitër Bajramit.

Pas faljes së namazit të Fitër

Bajramit, nën drejtimin e Myftiut, hytben e rastit e mbajti imami i xhamisë "Ebu Bekër", teologu Idmir Plaku.

Pas përfundimit të saj, të pranishmit këmbyen përshëndetjet, urimet dhe lutjet e kësaj dite të begatë festive.

Minber...

- 50 hytbe xhumaje -



Muhamed B. Sytari



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org